



# UNIVERSITETI I SHKODRËS

*“Luigj Gurakuqi”*

Fakulteti i Shkencave të Edukimit  
Departamenti i Arteve

## Rregullore për zhvillimin e konkursit

të pranimit në programin e studimit

### PEDAGOGJI MUZIKORE

(Cikli i parë i studimeve)

*Prof. Dr. Helen Belintieri*

Në zbatim të Ligjit Nr. 9741, Nr.9741, dt. 21.5.2007, i ndryshuar me Ligjin Nr.10 307, datë 22.7.2010 "Për Arsimin e Lartë në RSHP", Neni 33, "Pranimi në ciklin e parë të studimeve", pika 5; Kreu II, „Studimet në Ciklin e Parë“, Neni 62 "Pranimi në ciklin e parë të studimeve", Konkursët e Pranimeve në programin e studimit Pedagogji muzikore zhvillohen si më poshtë:

### **1. Pranimi i kandidatëve.**

1.1. Pranimi i kandidatëve në programin e studimit bëhet mbi bazën e rezultatit të konkurseve që zhvillohen pranë Fakulteteve përkatëse, në bazë të kriterëve të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, si dhe pikëve totale të "Maturës Shtetërore".

1.2. Pikët ndahen si më poshtë:

Gjithsej 300 pikë

Matura Shtetërore 30% të totalit

Konkursi i Pranimi 70% të totalit

Pragu minimal i fitimit të të drejtës së studimit 25% të totalit

1.3 Tarifat e regjistrimit për konkurim do të arkëtohen nëpërmjet sistemit mandat ose zyrave të Postës Shqiptare, për llogari të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë.

### **2. Procedura e organizimit dhe mbarëvatjes së konkursit.**


1.1. Dekani i Fakultetit merr masa dhe organizon ngritjen e Komisioneve të Vlerësimit të Kandidatëve (KVK) për Programet përkatëse mësimore. Përbërja e KVK shpallet një ditë para fillimit të konkurimit përkatës.

1.2. Në përbërje të KVK mund të aktivizohen punonjës mësimorë të përhershëm të departamenteve përkatëse, punonjës mësimorë të ftuar, si dhe titullarë të fushës përkatëse.

1.3. Në përbërjen e KVK nuk mund të jenë pedagogë apo anëtarë të tjerë të cilët kanë konflikt interesi me institucionin e Konkursit të Pranimi (KP).

1.4. Në mjediset ku zhvillohen KP nuk lejohet hyrja e personave pa autorizimin e titullarit të Fakultetit.

1.5. Të gjitha procedurat e konkurimit që kanë të bëjnë me organizimin dhe administrimin, vëzhgohen prej Komisionit të Verifikimit të Procedurave (KVP) të ngritur me urdhër të titullarit të Fakultetit.



1.6. Në fund të konkurimeve, KVP i përcjell titullarit të Fakultetit një raport mbi mbarëvajtjen e konkurimeve.

1.7. Të gjitha procedurat e konkurimit që kanë të bëjnë me organizimin dhe administrimin, vëzhgohen prej grupit përkatës të ngritur nga Rektorati.

### **3. Procedura e hyrjes së kandidatëve në mjediset e konkurimit.**

3.1. Kanë të drejtë të hyjnë në KP vetëm kandidatët që përmban lista e dërguar nga MAS.

3.2. KP zhvillohen në ambientet e Fakultetit. Periudha kohore në të cilën zhvillohen KP përcaktohen nga MAS.

3.3. Kalendarit i zhvillimit të KP së bashku me të dhëna të tjera (ambientet etj.) shpallen në mjediset e FM të paktën pesë ditë përpara fillimit të periudhës së konkurimeve.

3.4. Kryetari i KVK përkatës u komunikon kandidatëve Rregullat e Konkurimit ditën e parë të konkursit, pasi të jenë sistemuar në mjediset e zhvillimit të tij.

3.5. Lejohen të hyjnë në KP vetëm kandidatët e listës së shpallur për konkurim. Ata duhet të jenë të pajisur me dokument identifikimi (letërnjoftim, pasaportë për jashtë shteti ose çertifikatë me fotografi të vulosur). Kandidatët që nuk kanë asnjë prej këtyre dokumentave, nuk do të pranohen të marrin pjesë në konkurs.

3.6. Përpara se sa të marrë pjesë në KP, kandidati konkurent duhet të ketë depozituar pranë sekretarisë mandat-pagesën e kryer në llogari të institucionit, mbështetur në Udhëzimet e MAS.

3.7. Sekretaria mësimore i dorëzon Kryetarit të KVK përkatës materialet me listat e ardhura nga MAS.

### **4. Mënyra e organizimit të konkursit për Programin e studimit të nivelit të parë në PEDAGOGJI MUZIKORE**

Konkursi për pranimin e studentëve në Programin e studimit të nivelit të parë në Pedagogji Muzikore zhvillohet në dy faza:

a) Provim me shkrim në Solfezh dhe në Harmoni. Në Solfezh do të ketë diktat ritmik dhe diktat melodik (me një dhe me dy zëra), ndërsa në Harmoni studentit do t'i jepet të zgjidhë (me shkrim) dy ushtrime, një me melodi të dhënë dhe një tjetër me bas të dhënë. Kjo fazë e konkursit ka në dispozicion 30 % (tridhjetë përqind) e pikëve.

b) Provim formimi të përgjithshëm muzikor (me shkrim). Në këtë fazë të dytë, konkurentët do t'i nënshtrohen një provimi me shkrim i cili synon të testojë njohuri të formimit të përgjithshëm kulturor dhe sidomos njohuri të formimit muzikor të marrë në lëndët e ndryshme muzikore në

shkollën e mesme (nociione të teorisë muzikore, të harmonisë, të analizës së formës, të historisë së muzikës, të folklorit, etj). Ky test ka në dispozicion 60 % (gjashtëdhjetë përqind) të pikëve.

Lojë në instrument. Konkurentët do të luajnë një pjesë me përzgjedhje të lirë në një instrument muzikor (me parapëlqim pianoforten). Loja në instrument ka në dispozicion 10 % (dhjetë përqind) të pikëve.

### **5. Kriteret e vlerësimit dhe shpallja e kandidatëve fitues**

5.1. Vlerësimi i çdo kandidati bëhet prej KVK përkatës, përbërja dhe numri i të cilit përcaktohen nga titullari i Fakultetit. Në asnjë rast numri i anëtarëve të KP nuk duhet të jetë më i vogël se tre.

5.2. Vlerësimi i kandidatëve bëhet me pikë. Anëtarët e KVK disponojnë, për secilin kandidat një maksimum prej 210 (dyqind e dhjetë) pikësh (70% të totalit të KP).

5.3. Ndarja e pikëve të vlerësimit sipas fazave të KP ose kërkesave (zërave) të tij kryhet (përkatësisht) sipas ndarjes së parashikuar në Kriteret e Konkurimit dhe sipas Vendimit ad hoc të KVK.

5.4. Kandidatë fitues shpallen konkurentët që grumbullojnë numrin më të madh të pikëve në total në dispozicion.

5.5. Nuk mund të shpallet fitues asnjë kandidat i cili për çfarëdolloj arsyeje (mospjesëmarrje, mospërgatitje, etj) nuk merr asnjë pikë në ndonjërin prej fazave të konkursit.

5.6. Materialet përfundimtare të KP dorëzohen në MASH në dy forma:

5.6.1. Në formë elektronike, në një CD të firmosur me lapostil nga dekani

5.6.2. Në letër, të firmosura nga anëtarët e KVK përkatës.